

Gjuha dhe integrimi

[Integrimi](#)

[Ofertat për integrim](#)

[Gjuha](#)

[Me mësuë gjermanisht](#)

Integrimi

Prej huajave dhe të huajve pritët, që të integrohen në shoqëri. Kjo do të thotë me ju përmbajt ligjeve, ekonomikisht me u përkujdes vetë për vetën dhe me mësue gjermanisht.

Parimet themelore më të rëndësishme

Të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër duhet t`i përmbahen kushtetutes shtetërore (p.sh. barazia burr/grua) dhe t`iu përmbahen ligjeve ekzistuese. Pëveç kësaj pritët, që ekonomikisht njeriu të përkujdeset vetë për vetën, derisa është e mundshme. Prej të huajave dhe të huajve kërkohet, që sa më shpejt që të jetë e mundshme ta mësojnë gjuhën e vendbanimit. Mirëpo integrimi mund të bëhet vetëm nëse të dy palët japin kontribut. Për këtë pritët prej popullatës vendore hapje kundrejt të huajave dhe të huajve.

Përgjegjësia individuale

Shteti, kantonet dhe komunat përkujdesën për atë, që të huajat dhe të huajt ta kenë të drejtën e hyrjes në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Të huajat dhe të huajt duhet nga ana e tyre me përgjegjësi individuale të mundohen që të integrohen. Njeru pret prej tyre që ofertat e përgatitura të shfrytëzohen.

Pjesëmarrja në jetën shoqërore

Një mundësi të mirë për tu integruar në shoqërin zvicërore dhe për të njohur njerëz janë shoqatat. Mirëpo edhe festat dhe organizimet në komuna janë të përshtatshme me lidh kontakte. Ngritja mundet me qenë paksa e vështirë, jo të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër janë njësoj të hapur kundrejt kulturave të huaja. Nganjëherë nevojitet paksa durim.

Njoftime / mbështetje

Në kantonin Basel-Landschaft për të posa ardhurit ka në dispozicion zyra të ndryshme të kontaktit. Vendi i parë i mirë për tu njoftuar është komuna. Mirëpo ka edhe pika të tjera specifike për emigrante dhe emigrant. Shërbimi për të huajt (Ausländerdienst Baselland) informon për jetën në Zvicër dhe ju përgjigjen pyetjeve konkrete për tema të ndryshme. Pika e kontaktit (Anlaufstelle Baselland) ofron informacion mbi çështjet e ligjit të azilit dhe të të huajve. Kush nuk flet ende gjermanisht, mundet me e sjell dikend të përkthaj apo një përkthyes apo përkthyes. Për disa gjuhë ka oferta përkatëse.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi

Ofertat për integrim

Integrimi bëhet para s`gjithash në shkollë, shkollim profesional dhe punë. Për personat, që (ende) nuk kanë çasje në këto fusha, ka oferta të ndryshme për integrim.

Ofertat specifike

Ka oferta specifike të shumta për huajat dhe të huajt, të cilat ndihmojnë me u ambientuar në shoqërin zvicëre dhe me ndëlidhë kontakte. Ka ndër të tjera biseda në rreth, oferta për kohë të lirë, referate dhe kurse. Shërbimi për të huajt (Ausländerdienst ald) apo komuna ku banoni informojnë për ofertat. Shumë komuna e organizojnë një takim, për me i përshëndet banoret dhe banorët e rinj-një mundësi e mirë, për ta krijuar një pamje të përgjithshme.

Shoqatat

Shumë banore dhe banorë të kantonit Basel-Landschaft janë anëtarë në një shoqatë (Verein). Ka shumë shoqata për interesa të ndryshme. Edhe në komuna të vogla ekzistojnë shoqata për sport-, kulturë dhe të tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për me ra në kontakt me njerëzit e tjerë. Shumica e shoqatave janë për të gjithë personat të hapura. Informacione për shoqata, gjinden edhe në faqet e internetit të komunave.

Organizatat e Migrimit (DE)

Sipas gjuhës, vendit të ardhjes apo besimit ka shoqata të ndryshme, në të cilat emigrantet dhe emigrantët organizohen vetë. Shpesh ofrojnë këto shoqata oferta për integrim dhe këshillim, për me i mbështet antarët e tyre në Zvicër dhe në kantonin Basel-Landschaft.

Ofertat për të rinjë

Për të rinjët ka në kantonin Basel-Landschaft shumë oferta specifike, për ta kaluar kohën e lirë dhe me njoftë bashkëmohatar. Në shumë komuna ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjë janë nën përkujdesje, munden me i sjell idetët dhe me i zbatue projektet e tyre (Jugendarbeit). Ofertat janë zakonisht falas. Shoqatat për të rinjë ofrojnë mundësin, që s`bashku me bashkëmohatar të ndërmarrin aktivitete dhe të ushtrojnë sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, komunat apo kishat e vendit. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjët. Komuna jep njoftime të tjera.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/ofertat-per-integrim

Gjuha

Ju keni ardhur me shtëpi në Basel-Landschaft dhe ende nuk e flisni gjuhën gjermane? Atëherë bëni mirë të mësoni sa më parë gjermanisht. Kur flisni gjuhën, ju njiheni më mirë me vendin dhe njerëzit. Dhe gjeni më lehtë punë.

Gjuha letrare gjermane / gjermanishtja zvicerane

Zvicra ka katër gjuhë vendore: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retroromanisht. Në kantonin Basel-Landschaft gjuha gjermane është gjuha zyrtare. Ka gjuhën letrare gjermane (Hochdeutsch) dhe gjermanishten zvicerane (Schweizerdeutsch).

- Gjermanishtja standarde (Standarddeutsch)
Njerëzit në pjesën gjermane të Zvicrës shkruajnë në gjermanishten standarde. Dhe ata flasin gjermanishten standarde në shkollë dhe pjesërisht ë radio dhe në televizor.
- Gjermanishtja zvicerane (Schweizerdeutsch)
Gjermanishtja zvicerane është një dialekt i gjuhës gjermane. Njerëzit flasin në jetën e përditshme më shumë gjermanishten zvicerane. Ndoshta gjermanishten zvicerane e keni të vështirë të kuptoni, edhe kur tashme flisni mirë gjermanisht. Ju nuk kuptoni diçka? Atëherë mund të lutni njerëzit me gjithë dëshirë, që ata të flasin gjermanishten standarde me ju. Nuk është nevoja që ju vetë të flisni gjermanishten zvicerane. Por është e rëndësishme që ta kuptoni pas një farë kohe.

Gjermanishtja dhe fëmijët

Fëmija juaj flet një gjuhë tjetër në vend të gjermanishtes? Atëherë ai duhet të njihet sa më parë me fëmijët, që flasin gjermanisht. Kështu fëmija juaj mëson më shpejt. Ai mund të shkojë për shembull në një grup për lojë. Ka edhe oferta speciale për prindër dhe fëmijë.

Edhe ju mund të përkrahni fëmijën tuaj në zhvillimin e tij gjuhësor. Flisni shumë me fëmijën tuaj, dëgjoni, kur fëmija juaj flet, dhe tregoni histori. Flisni në atë gjuhë, të cilën zotoni më mirë dhe që e preferoni.

Përkthimet me shkrim / Përkthimet me gojë

Ju sapo keni ardhur me shtëpi në Basel-Landschaft dhe ende nuk flisni mirë gjermanisht? Atëherë nganjëherë ju duhet një person, që përkthen për ju. Ndoshta mund të pyesni të afërmit ose persona të njohur.

Mirëpo ka situata, në të cilat janë të vështira ose shumë personale. Për shembull një takim në spital ose në një zyrë. Atëherë ju dëshironi më mirë një përkthyes ndërkulturore ose një përkthyes ndërkulturore. Këta janë specialistë posaçërisht për njerëz, që vijnë nga një kulturë tjetër. Specialistet njohin kulturën tuaj dhe mund të përkthejnë në këtë mënyrë, që ju kuptoni gjithçka.

Ju merrni letra nga zyra shtetërore dhe nuk e kuptoni? Ose duhet të plotësoni një formular ose të shkruani një letër? Këtu gjeni ndihmë:

- Shërbimi i përkthimit nga Ausländerdienst ald
- Schreibstube Liestal

Nivelet e gjuhës në emigracion dhe të drejtën civile

Ndoshta doni të aplikoni për leje qëndrimi (B) ose leje vendbanimi (C). Ose dëshironi marrjen e nënshtetësisë. Gjermanishtja nuk është gjuha juaj e parë? Atëherë ju duhet një vërtetim, që flisni mirë gjermanisht.

Këtu merrni informacione, se çfarë ju duhet për aplikimin:

- Zyra e migracionit (Amt für Migration und Bürgerrecht)

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha

Me mësue gjermanisht

Me mësue saktë gjermanisht, preferohet shkuarja në një kurs të gjuhës gjermane. Oferta për kurse në rajonin Basel është e gjerë dhe e orientuar në situata të ndryshme jetësore.

Ofertat

Shumë ofertues udhëheqin në rajonin Basel kurse të gjuhës për grupe të ndryshme. Disa ofertues janë ndërmarrje komerciale, tjerët janë me interes të përgjithshëm apo institucione shtetërore. Kush nuk e zotëron alfabetin latin apo ka vështërsi me shkrim e lexim, mundet me e vizitue një kurs për me e mësue alfabetin (Alphabetisierungskurs). Para se me e bërë një kurs të gjuhës gjermane njeriu duhet të informohet për llojet e ndryshme të kurseve dhe shpenzimet. Për prindërit me fëmijët e tyre ka kurse speciale me përkujdesje fëmijësh. Zyra e të huajve Baselland (Ausländerdienst Baselland ald) apo komuna ku banoni informojnë për ofertat.

Nivelet gjuhësore

Në ç' nivel një njeri flet gjermanisht, kjo mund të matet me "Kornizën referuese e përbashkët evropiane". Shkurtimi për te është GER. GER është matësi për gjuhën dhe ka 6 nivele A1, A2, B1, B2, C1 und C2. Kur keni arritur nivelin A1 ose A2, keni njohuri bazë në gjermanisht. Kur arrini nivelin C1 ose C2, ju keni përparuar shumë.

- Ju dëshironi të bëni një formim profesional, që njihet në Zvicër? Atëherë ju duhet niveli B1 ose B2.
- Kur dëshironi të studioni në një universitet, ju duhet niveli C1 ose C2.

Finanzimi

Kurset e gjermanishtës zakonisht duhet të paguhen vet. çmimet janë të ndryshme dhe e vlen të krahasohen ofertat (çmimi për një njësi mësimore). Disa kurse mbështeten financiarisht prej kantonit Basel-Landschaft apo komunave dhe për pjesëmarrësit janë më lirë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/me-mesue-gjermanisht